



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-05

**Prokurori kundër Salih Mustafës**

**Vendosi:** Trupi Gjykses I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 7 shtator 2021

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim mbi Konstatimin Gjyqësor të Fakteve të Shqyrtuara në Procese të Tjera**

---

**T'i njoftohet:**

**Prokurorit të Specializuar**

Xhek Smith

**Mbrojtjes së të akuzuarit**

Julius von Bone

**Mbrojtëses së viktimave:**

Ani Pues

**TRUPI GJYKUES I** (“Trupi Gjykues”)<sup>1</sup> nxjerr këtë vendim mbi konstatimin gjyqësor të fakteve të shqyrtuara në procese të tjera.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 20 maj 2021, Trupi Gjykues nxori “Vendimin për Caktimin e Datave për Mbajtjen e Konferencave Përgatitore për Gjykimin dhe për Parashtrime nga Palët”, në të cilin Trupi Gjykues kërkoi parashtrime nga Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS-ja) dhe Mbrojtja e Salih Mustafës (z. Mustafa ose i akuzuari) në lidhje me mundësinë për të kërkuar nga Trupi Gjykues konstatim gjyqësor të fakteve të shqyrtuara në procese të tjera dhe në rast se po, për sa prej këtyre fakteve.<sup>2</sup>

2. Më 9 qershor 2021, gjatë konferencës përgatitore për gjykim, palët njoftuan Trupin Gjykues se vazhdonin diskutimet *inter partes* për faktet e shqyrtuara në procese të tjera.<sup>3</sup> Më tej, palët u shprehën se ato mund të paraqisnin kërkesa të përbashkëta ose më vete, në varësi të faktit nëse do të arrinin të pajtoheshin, për të kërkuar konstatim gjyqësor të fakteve të shqyrtuara në procese të tjera, nëse do të kishte të tilla, deri në fund të qershorit 2021.<sup>4</sup>

3. Më 18 qershor 2021 Trupi Gjykues nxori “Vendimin mbi Datën e Fillimit të Gjyimit dhe Pika të Tjera që lidhen me të”, me të cilin urdhëroi ZPS-në dhe Mbrojtjen që, deri me datë 30 qershor 2021, të paraqisnin parashtrime të

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-05, F00114, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Trupit Gjykues*, 5 maj 2021, publik.

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-05, F00123, Trupi Gjykues I, *Vendim për Caktimin e Datave për Mbajtjen e Konferencave Përgatitore për Gjykimin dhe për Parashtrime nga Palët*, 20 maj 2021, publik, para. 10, pika 7, me Shtojcat 1-2, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-05, Transkript, 9 qershor 2021 (Transkripti i 9 qershorit 2021), publik, f. 239, rreshti 11 deri në f. 240, rreshti 14.

<sup>4</sup> Transkripti i 9 qershorit 2021, f. 240, rreshti 24 deri në f. 244, rreshti 13.

përbashkëta dhe/ose veç e veç për t'i kërkuar Trupit Gjykses konstatim gjyqsor të fakteve të shqyrtuara në procese të tjera.<sup>5</sup>

4. Më 29 qershor 2021, Mbrojtja e z. Mustafa njoftoi Trupin Gjykses se nuk kishte rënë dakord me ZPS-në për një propozim të përbashkët për t'i kërkuar Trupit Gjykses konstatimin gjyqsor të fakteve të shqyrtuara në procese të tjera dhe se nuk do t'i kërkonte të bënte konstatim gjyqsor të fakteve të shqyrtuara në procese të tjera.<sup>6</sup>

5. Më 30 qershor 2021, ZPS-ja propozoi një listë faktesh të shqyrtuara në procese të tjera dhe kërkoi konstatimin gjyqsor të tyre (Kërkesa e ZPS-së).<sup>7</sup> Mbrojtja e z. Mustafa nuk iu përgjigj Kërkesës së ZPS-së.

## II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

6. Trupi Gjykses vë në dukje nenin 40(2) dhe (6) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe rregullat 116(1) dhe 157(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (Rregullorja).

## III. PARASHTRIMET E PALËVE

7. ZPS-ja i kërkon Trupit Gjykses të bëjë konstatimin gjyqsor të 52 fakteve (faktet e propozuara) që kanë lidhje me këtë çështje, të shqyrtuara në procese të tjera, të në procese përmbyllëse të gjykatave në Kosovë dhe në Tribunalin Penal

---

<sup>5</sup> KSC-BC-2020-05, F00138, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Datën e Fillimit të Gjykimit dhe Pika të Tjera që lidhen me të*, 18 qershor 2021, publik, para. 8.

<sup>6</sup> KSC-BC-2020-05, F00142, Mbrojtja, *Parashtrim i Mbrojtjes për Faktet e Shqyrtuara në Procese të Tjera (Parashtrimi i Mbrojtjes)*, 29 qershor 2021, publik, para 2-3.

<sup>7</sup> KSC-BC-2020-05, F00144, Prokurori i Specializuar, *Mocioni i Prokurorisë për Konstatim Gjyqsor të Fakteve të Shqyrtuara në Procese të Tjera*, 30 qershor 2021, publik, me shtojcën 1, publike, që përmban listën e fakteve të shqyrtuara në procese të tjera për të cilat ZPS-ja kërkon nga Trupi Gjykses konstatimin gjyqsor.

Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë.<sup>8</sup> ZPS-ja parashtron se faktet e propozuara përmbushin kriteret për konstatim gjyqësor pasi kanë lidhje me çështjen, kanë natyrë konkrete dhe janë identifikuar me saktësi të mjaftueshme; ato burojnë nga procese përmbyllëse para juridiksioneve të tjera; dhe nuk kanë lidhje me veprime të kryera nga i akuzuari sipas Aktakuzës (së konfirmuar).<sup>9</sup>

8. Mbrojtja e z. Mustafa parashtron se synon të paraqesë prova (dëshmi ekspertësh) për natyrën e konfliktit, forcat që vepronin aty, dhe legjitimitetin e forcave agresore që vepronin në territorin e Kosovës, që ajo mendon se do të çojnë në rivlerësimin dhe ricilësimin e problemeve dhe ngjarjeve të lartpërmendura.<sup>10</sup>

#### IV. DISKUTIM

##### A. KRITERET LIGJORE

9. Rregulla 157(2) e Rregullores ka si qëllim arritjen e efikasitetit gjyqësor (“në interes të gjykimit të drejtë dhe të shpejtë”) duke i dhënë Trupit Gjykes kompetenca diskrecionale për konstatimin gjyqësor të fakteve të shqyrtuara në procese të tjera të Dhomave të Specializuara ose në procese përmbyllëse të gjykatave të Kosovës ose në juridiksione të tjera që kanë lidhje me çështjen në fjalë, duke evituar në këtë mënyrë paraqitjen e provave në lidhje me faktet e vërtetuara në proceset e tjera në bazë të provave të paraqitura.<sup>11</sup> Duke vepruar në këtë mënyrë, Trupi Gjykes duhet të garantojë në të njëjtën kohë respektimin e të drejtave të të akuzuarit për gjykim të drejtë dhe të shpejtë, siç kërkohet nga rregulla 157(2) e Rregullores.

<sup>8</sup> Kërkesa e ZPS-së, para. 1 dhe Shtojca 1.

<sup>9</sup> Kërkesa e ZPS-së, para. 6.

<sup>10</sup> Parashtrimi i Mbrojtjes, para. 4.

<sup>11</sup> Ngjashëm, ICTY, *Prosecutor v. Karadžić*, IT-95-5/18-T, Trial Chamber, [Decision on Accused's Motion for Judicial Notice of Adjudicated Facts related to count one](#) (Karadžić Decision), 21 January 2014, para. 4; ICTR, Appeals Chamber, *Prosecutor v. Bagosora et al.*, ICTR-98-41-A, [Decision on Anatole Nsengiyumva's Motion for Judicial Notice](#), 29 October 2010, para. 10.

10. Në ushtrimin e diskrecionit të tij, Trupi Gjykses do të marrë parasysh ndërmjet të tjerave faktorët e mëposhtëm: (i) faktet e propozuara nuk kanë lidhje me veprimet dhe sjelljen e të akuzuarit që përmenden si akuza në aktakuzën e konfirmuar, dhe kanë lidhje me problemet në fjalë në procesin aktual, siç përcaktohet në rregullën 157(2) të Rregullores; (ii) faktet e propozuara janë të dallueshme, konkrete dhe të identifikueshme;<sup>12</sup> (iii) faktet e propozuara, siç janë formuluar nga pala parashtruese nuk ndryshojnë në mënyrë thelbësore nga formulimi në aktvendimin origjinal;<sup>13</sup> (iv) faktet e propozuara nuk janë të paqarta apo çorientuese në kontekstin e paraqitur në mocionin e palës parashtruese;<sup>14</sup> (v) faktet e propozuara nuk përmbajnë konstatime ose cilësime ligjore (vi) faktet e propozuara nuk bazohen në marrëveshje mes palëve të procesit origjinal;<sup>15</sup> dhe (vii) faktet e propozuara nuk janë në proces apelimi ose rishikimi.<sup>16</sup>

11. Me anë të konstatimit gjyqësor të fakteve të shqyrtuara më parë, Trupi Gjykses përcakton një prezumim të bazuar mirë për saktësinë e këtyre fakteve, të cilat për këtë arsye nuk është e nevojshme të vërtetohen sërish gjatë procesit gjyqësor.<sup>17</sup> Duke qenë

<sup>12</sup> Ngjashëm, ICTY, *Prosecutor v. Perišić*, IT-04-81-PT, Trial Chamber I, [Decision on Prosecution's Motion for Judicial Notice of Adjudicated Facts Concerning Sarajevo](#), 26 June 2008, para. 18; *Prosecutor v. Prlić et al.*, IT-04-74-PT, Trial Chamber II, [Decision on Motion for Judicial Notice of Adjudicated Facts Pursuant to Rule 94\(b\)](#) (Prlić Decision), 14 March 2006, para. 12; *Prosecutor v. Hadžihasanović & Kubura*, IT-01-47-T, Trial Chamber II, [Decision on Judicial Notice of Adjudicated Facts Folloëing the Motions Submitted by Counsel for the Accused Hadžihasanović and Kubura on 20 January 2005](#) (Hadžihasanović Decision), 14 April 2005, p. 5.

<sup>13</sup> Ngjashëm, ICTY, [Karadžić Decision](#), para. 6; *Prosecutor v. Popović et al.*, IT-05-88-T, Trial Chamber II, [Decision on Prosecution Motion for Judicial Notice of Adjudicated Facts ëith Annex](#) (Popović Decision), 26 September 2006, para. 7; *Prosecutor v. Blagojević & Jokić*, IT-02-60-T, Trial Chamber I, [Decision on Prosecution's Motion for Judicial Notice of Adjudicated Facts and Documentary Evidence](#) (Blagojević Decision), 19 December 2003, para. 16.

<sup>14</sup> Ngjashëm, ICTY, [Popović Decision](#), para. 8.

<sup>15</sup> Ngjashëm, ICTY, *Prosecutor v. Krajišnik*, IT-00-39-PT, Trial Chamber I, [Decision on Prosecution Motions for Judicial Notice of Adjudicated Facts and for Admission of Written Statements of Eitnesses Pursuant to Rule 92 bis](#), 28 February 2003, para. 14; [Popović Decision](#), para. 11.

<sup>16</sup> Ngjashëm, ICTY, *The Prosecutor v. Ratko Mladić*, IT-09-92, Appeals Chamber, [Decision on Ratko Mladić's Appeal Against the Trial Chamber's Decisions on the Prosecution Motion for Judicial Notice of Adjudicated Facts](#), 12 November 2013, paras 92, 94; [Popović Decision](#), para. 14.

<sup>17</sup> Ngjashëm, ICTY, *Prosecutor v. S. Milošević*, IT-02-54-AR73.5, Appeals Chambers, [Decision on the Prosecution's Interlocutory Appeal against the Trial Chamber's 10 April 2003 Decision on Prosecution Motion for Judicial Notice of Adjudicated Facts](#), 28 October 2003 (Milošević Decision), p. 3; [Karadžić Decision](#), para.

një prezumim, pala tjetër mund të paraqesë në gjykim prova të cilat kundërshtojnë saktësinë e fakteve në fjalë.<sup>18</sup>

#### B. FAKTET E SHQYRTUARA NË PROCESE TË TJERA

12. Trupi Gjykses vëren se faktet e propozuara kanë lidhje kryesisht me ekzistencën e konfliktit të armatosur (faktet e propozuara 1-6) ndërmjet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) (faktet e propozuara 32-52) dhe forcave të ish-Republikës Federale të Jugosllavisë që luftonin së bashku me forcat serbe (faktet e propozuara 7-31).

13. Pasi ka vlerësuar me kujdes faktet e propozuara (1-52) sipas kriterëve të përcaktuara në paragrafin 10 më lart, Trupi Gjykses është i mendimit se të gjitha faktet e propozuara (1-52) i përmbushin kriteret e përsëritura më sipër. Disa prej fakteve të propozuara që i takojnë periudhës para periudhës së Aktakuzës, Trupi Gjykses i konsideron të rëndësishme sa i përket nivelit të organizimit të UÇK-së dhe për të dhënë informacion mbi kontekstin e pretendimeve në këtë çështje.<sup>19</sup>

14. Për pasojë, Trupi Gjykses gjykon se konstatimi gjyqësor i fakteve të sipërpërmendura i është në interes të drejtësisë dhe të gjykimit të drejtë dhe të shpejtë e rrjedhimisht, bën konstatimin gjyqësor të Fakteve të Propozuara (1-52). Ky konstatim nuk cenon të drejtën e Mbrojtjes së Z. Mustafa që të paraqesë prova që kundërshtojnë vërtetësinë e fakteve të propozuara (1-52).

---

5; SCSL, *Prosecutor v. Issa Hassan Sesay, Morris Kallon and Augustine Gbao*, SCSL-04-15-T, [Decision on Sesay Defence Application for Judicial Notice to be taken of Adjudicated Facts under Rule 94\(b\)](#), 23 June 2008, para. 18.

<sup>18</sup> Ngjashëm, ICTY, [Hadžihasanović Decision](#), p. 4; [Milošević Decision](#), p. 3; *Prosecutor v. Lukić and Lukić*, IT-98-32/1-A, [Appeal Judgement](#), 4 December 2012, para. 261.

<sup>19</sup> Kërkesa e ZPS -së, para. 4.

V. VENDIM

15. Për arsyet e sipërpërmendura, Trupi Gjykues:

- a. **MIRATON** Kërkesën e ZPS-së; dhe
- b. **BËN** konstatimin gjyqësor të fakteve të propozuara (1-52) të përfshira në Shtojcën 1 të Kërkesës së ZPS-së.

                  /nënshkrimi/                    
**Gjykatëse Mapi Feld-Folia**  
**Kryegjykatëse**

                  /nënshkrimi/                    
**Gjykatës Zhilber Biti**

                  /nënshkrimi/                    
**Gjykatës Roland Dekers**

7 shtator 2021  
Në Hagë, Holandë.